



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBER
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT - V E N D I M

Nr. _____ Date 10/15/2021

“Për përdorimin e fondit nga transferata e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit Tungjatjeta Jete”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021:

Kërkojmë:

- I. Në bazë të vijimësisë së marrëveshjes së bashkëpunimit për financimin e projektit “Tungjatjeta Jetë” midis Bashkisë Dibër dhe financimit të projektit “Tungjatjeta Jetë” World Vision e cila do të miratohet në Këshillin Bashkiak Dibër kërkojmë miratimin e këtij projekt-propozimi ti shtohet buxhetit të Bashkisë Dibër, me kontribut të World Vision 3.272.000 lekë dhe bashkëfinancimin e Bashkisë Dibër me vlerë 1.000.000 lekë TOTAL : 4.272.000 lekë.
- II. Kjo marrëveshje është 1- vjecare dhe pagesa do llogaritet që në muajin Maj 2021 me personelin aktual të marrëveshjes së mëparëshme. Ndryshimet që janë bërë në buxhetin e vitit 2021 janë bërë nga muaji Maj – Dhjetor 2021. Nga llogaritjet për shpenzimet mujore totale për paga dhe sigurime janë në vlerën 355.999 lekë, llogaritjet për 8 muaj janë në vlerën 2.847.992 lekë nga të cilat $8 \times 272.666 = 2.181.328$ do jenë kontribut i World Vision dhe $8 \times 83.333 = 666.664$ lekë do të jenë kontribut i bashkëfinancimit të bashkisë, diferenca prej 1.424.008 lekë do meret parasysh për tu detajuar në buxhetin e vitit 2022.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Personelit dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:


Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora LALA



P/Sektorit Shërbimit Social

Ardit HOXHA




P/Sektorit Juridik

Elona LUSHA




Drejtor Ekonomik

Lorenc CIBAKU



KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

Drejtuar: Prefektit të Qarkut Dibër

Relacion në lidhje me vendimin nr.44 datë 11.10.2021

Në lidhje me vendimin nr.44 datë 11.10.2021 "Për përdorimin e fondit nga transferata e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit "Tungjatjeta Jete" është kërkuar për miratim duke qënë që ka një marrëveshje partneriteti me nr. 1349 prot. datë 21.04.2021 midis Bashkisë Dibër dhe World Vision Albania për mbështetje ndaj fëmijëve me aftësi ndryshe nëpër njësitë administrative. Ky projekt është në vitin e tretë të financimit ku World Vision Albania ka një kontribut në vlerën e 3.272.000 (tremilion e dyqind e shtatëdhjetë e dymijë) lekë, ndërsa bashkëfinancimi i bashkisë Dibër është 1.000.000 (njëmilion) lekë. Numri i punjoësve është miratuar në vendimin e këshillit bashkiak për numrin e përgjithshëm të Bashkisë Dibër.

Bashkëngjitur këtij relacioni është marrëveshja e partneritetit dhe tabela e përlogaritjeve të termave financiarë për bashkëfinancimin e këtij projekti.

Drejtori Ekonomik
Lorenc CIBAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 44 Datë 11.10.2021

“Për përdorimin e fondit nga transferta e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit Tungjatjeta Jete”


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021: Keshilli Bashkiak ne piken te ndryshme, datë 11.10.2020 me 16 vota pro 0 vota kundër.

Vendosi

1. Në bazë të vijimësisë së marrëveshjes së bashkëpunimit për financimin e projektit “Tungjatjeta Jete” midis Bashkisë Dibër dhe financimit të projektit “Tungjatjeta Jete” World Vision me Bashkinë Dibër, me kontribut të World Vision 3.272.000 lekë dhe bashkëfinancimin e Bashkisë Dibër me vlerë 1.000.000 lekë TOTAL : 4.272.000 lekë.
2. Kjo marrëveshje është 1- vjecare dhe pagesa do llogaritet që në muajin Maj 2021 me personelin aktual të marrëveshjes së mëparëshme. Ndryshimet që janë bërë në buxhetin e vitit 2021 janë bërë nga muaji Maj – Dhjetor 2021. Nga llogaritjet për shpenzimet mujore totale për paga dhe sigurime janë në vlerën 355.999 lekë, llogaritjet për 8 muaj janë në vlerën 2.847.992 lekë nga të cilat $8 \times 272.666 = 2.181.328$ do jenë kontribut i World Vision dhe $8 \times 83.333 = 666.664$ lekë do të jenë kontribut i bashkëfinancimit të bashkisë, diferenca prej 1.424.008 lekë do meret parasysh për tu detajuar në buxhetin e vitit 2022.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Personelit dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





3424/
26/10/21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.974/2 .prot.

Peshkopi, më 25.10.2021

Lënda : Per vendimin nr. 44, datë 11.10.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në institucionin e Prefektit është depozituar vendimi nr.44, datë 11.10.2021 “Për përdorimin e fondit nga transfera World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit Tungjatjeta Jetë”, vendim që ju kthye për formulim dhe plotësim dokumentacioni Bashkisë Dibër.

Në këndvështrim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ , si ato të percaktuara në nenin 3 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” që shprehet se “konsiderohet akt normativ nënligjor akti që vendos rregulla të përgjithshme të sjelljes të organit publik dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij “.

Për rastin konkret, kemi të bëjme me një marrëveshje partneriteti mes Bashkisë Dibër dhe World Vision Albania, ku të drejtat dhe detyrimet e palëve të cilat janë plotësisht të individualizuara rregullohen veç të tjerash nga dispozitat e Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë.

Parë problemin nën dritën e arsytimit të mësipërm, Prefekti e gjen me vend të miratojë në parim një vendimmarrje të tillë, pasi për të gjitha efektet e ligjit veprime të tilla juridiko-civile qofshin këto edhe të karakterit financiar që burojnë nga detyrimi për zbatimin e Marrëveshjes së Partneritetit, janë përgjegjësi direkte administrativo- ligjore e organit ekzekutiv dhe strukturave të saj përgjegjëse.

strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt-vendime të kësaj natyre në kushtet e zbatimit me korrektesi legjislacionin aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances e probleme të ngjashme me to .

